



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 96 dt.30.07.1996

Këshillit Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.30.07.1996, pasi dëgjoi ankesën e antarit të Këshillit Bashkiak Z.Fatmir Maci lidhur me pezullimin nga puna e tij si Kryetar i K.K.K.P të Rajonit Nr.1 si dhe Drejtor i Ndërmarrjes Komunale Banesa të bërë nga Shërbimi Kontrollit të Shtetit, në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992 “Për organizimin e funksionimin e Pushtetit Lokal” me miratimin total të të gjithë antarëve të Këshillit

VENDOSI

1. Meqënëse shkarkimi i Z.Fatmir Maci nga këto funksione është kompetencë e Këshillit Bashkiak u gjykua si më poshtë :

1.Deri sa në Këshillin Bashkiak të vijë materiali i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit për analizën që i është bërë punës së komisionit të K.K.K.P të Rajonit Nr.1 dhe Ndërmarrjes Komunale Banesa, Z.Fatmir Maci të vazhdojë punën që ka patur.

2.Në një mbledhje të veçantë të Këshillit Bashkiak do të trajtohet çështja e Z.Fatmir Maci, pasi Këshilli të ketë marrë materialin e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, do të vendoset përfundimisht së çfarë qëndrimi do të mbajë K.Bashkiak për këtë problem.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Personelit të Bashkisë së Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA